



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS  
REKTORATI**

Nr.496 prot

Durrës, më 31. 03. 2020

**VENDIM**

**Nr. 4, datë 31.03.2020**

Në mbështetje të ligjit nr. 80|2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”, të vendimit të këshillit të ministrave nr.658, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të statutit dhe rregullores së Universitetit Aleksandër Moisiu, Rektorati në mbledhjen e datës 31.03.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së lektorëve me kohë të pjesshme sipas listës dhe procedurës së rekrutimit të kryer dhe përcjellë nga fakultetet pranë sektorit të burimeve njerëzore.
2. Përcjelljen nga drejtuesit e njësive kryesore të tabelës së ngarkesës mësimore për semestrin e dytë për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme me orët brenda dhe jashtë auditorit deri me datë 02.04.2020. Në rastet specifike, kur ngarkesa e orëve suplementare brenda auditorit kalon 200 orë, tabela të shoqerohet me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Për orët suplementare jashtë auditorit, të përcaktohet metodologjia e ndarjes së ngarkesës.
3. Ngakimin e drejtorisë së kurrikulës dhe standarteve të cilësisë për përmbledhjen e ngarkesës vjetore faktike brenda auditorit për lektorët me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe finalizimin e ngarkesës vjetore jashtë auditorit deri me datë 09.04.2020.
4. Ngakimin e drejtuesve të njësive kryesore në bashkërendim me drejtorin e drejtorisë së kurrikulës dhe standarteve të cilësisë për hartimin e relacionit në përgjigje të MASR mbi programet e reja dhe riorganizimin e programeve të kërkuara nga UAMD deri me datë 06.04.2020.
5. Përcjelljen e dokumentacionit për programet e reja ose riorganizimin e programeve të miratuara paraprakisht nga MASR pranë drejtorisë së kurrikulës dhe standarteve të cilësisë brenda afatit ligjor në fuqi.
6. Ngarkimin e Administratorit për pagesën e tarifës për hapjen e programeve të reja të

studimit sipas mandat pagesës të përcjellë nga MASR.

7. Dokumentimin në vazhdimësi të procesit të mësimit në distancë sipas modelit të raportimit javor të këtij procesi.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
  - Zv. Rektorët
  - Administratori
  - Drejtuesit e njësive kryesore
  - Drejtoria e burimeve njerëzore dhe juridike
  - Drejtoria e kurrikulës dhe standarteve të cilësisë
  - Drejtoria e shërbimeve akademike
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

